VENDIM
Nr. 122, datë 13.2.2013

PËR SHPALLJEN E ZONËS ARKEOLOGJIKE "A" DHE "B" TË KALASË SË NDROQIT, KOMUNA NDROQ, DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SË ADMINISTRIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 31 pika 1 e 53 pikat 1 e 2 të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e zonës arkeologjike "A" dhe "B" të Kalasë së Ndroqit, komuna Ndroq, sipas hartës dhe koordinatave gjeografike të përcaktuara në aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Miratimin e rregullores së administrimit të zonës arkeologjike "A" dhe "B" të Kalasë së Ndroqit, komuna Ndroq, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe komuna Ndroq për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha